



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2023:251962

Datë: 01.10.2024

Numri i dokumentit: 06234002

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ- Dega në Kaçanik-Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil, gjyqtar Riza Livoreka, me sekretaren juridike Azemine Berisha, në çështjen juridiko-kontestimore të paditësit Xh. T. , nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, me nr. personal ..., të cilin me autorizim e përfaqëson Avokati Sh. V. nga Kaçaniku, kundër të paditurve: Sh. (Isuf) T. nga fshati ... Komuna e Kaçanikut dhe Xh. (I.) T. nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, për çështjen kontestues, vërtetimi i të drejtës së pronësisë, jashtë seancës gjyqësore, me datë 01.10.2024, ku edhe në të njëjtën ditë mori dhe bëri përpilimin me shkrim të këtij:

A K T G J Y K I M

(Në bazë të pohimit)

I. APROVOHET në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit Xh. T. , nga fshati ... Komuna e Kaçanikut, dhe **VËRTETOHET** se paditësi është pronarë i vetëm i paluajtshmërive dhe atë njëjësive kadastrale me sa vijon:

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë, Arë e klasës 3, në sipërfaqe prej 2156m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kultur arë e klasës 3, në sipërfaqe prej 1062m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë mal i klasës 3, në sipërfaqe prej 6040m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë arë e klasës 3, në sipërfaqe prej 1148 m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë, tokë Ndërtimore- Oborr, në sipërfaqe prej 7599m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë, arë e klasës 6, në sipërfaqe prej 459m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë mal i klasës 3, në sipërfaqe prej 464m²,

- në 1/1 të pk.nr. ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë Kullosë e klasës 3, në sipërfaqe prej 2246m² dhe

- në 1/1 të njësinë kadastrale ..., në vendin e quajtur "...", me kulturë mal i klasës 3, në sipërfaqe prej 1398m², të gjitha në ZK ... Komuna e Kaçanikut , të evidentuara sipas certifikatës pronësore me numër: me numër të lëndës 29928/2023, në emër të I. (R.) T. , e lëshuar nga zyra Kadastrale Komunale Kaçanik.

II. Ky Aktgjykim ka titull përmbarimorë dhe shërben si bazë juridike për regjistrimin e paluajtshmërive në Regjistrin e të Drejtave Pronësore.

III. DETYROHET pala paditëse që ta paguaj shumën prej 60,00€, në emër të taksës për padi, kësaj shume duhet ti zbritet shuma prej 20.00€, sepse këtë shumë e ka paguar pala paditëse, për pagës mbete shuma prej 40.00€, e cila pagës do të bëhet në afat prej 7 ditëve, nga dita e pranimi të aktgjykimit.

A r s y e t i m

Paditësit më datën 20.10.2023, në këtë Gjykatë, ka ushtruar padi, me të cilën ka kërkuar vërtetimin e pronësisë dhe ka theksuar se pasuria e paluajtshme evidentohet në emër të I. T., baba i të paditurve. Ka shtuar se njësit kadastrale paditësi i ka blerë në muajin marse të vitit 1973,

në shumë prej 20.000 DM, me kontratën verbale, e cila praktikohet në atë kohë dhe menjë herë e ka paguar çmimin e kontraktuar.

Paditësi pas blerjes së pasurisë kontestuese, me një herë ka hyrë në posedim, të pa ndërprerë dhe i pa penguar nga askush as nga të paditurit, këtë fakt e pohojnë edhe palët e paditura në përgjigjeje në padi.

Pala paditëse insiston në rregullimin e dokumentacionit dhe bartjen e pronësisë në këtë paluajtshmëri edhe në mënyrë formale në emrin e tij, mbi bazën e këtyre theksimeve i ka propozuar gjykatës që ta miratoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar.

Ka kërkuar nga gjykata që kërkesëpadinë ta miratoj në tërësi si të bazuar, sepse këto prona janë në shfrytëzim të qetë dhe të pa penguar nga paditësi, prandaj i njëjti e ka fituar të drejtën e pronësisë edhe mbi bazën e parashkrimit fitues konform nenit 40 pika 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata më datë 14.06.2023, e ka nxjerrë aktvendimin për përgjigjeje në padi, me të cilin i ka detyruar të paditurit që në afat prej 15 ditëve të paraqesin përgjigjeje në padi dhe ti paraqesin prapësimet procedurale të deklarohen se a e pranojnë apo e kontestojnë kërkesëpadinë e paditësve.

Gjykata përmes dorëzuesit të gjykatës, të paditurve javë ka dorëzuar, padinë me prova dhe aktvendimin për përgjigjeje në padi, me datën 19.06.2024, këtë fakt e vërtetoi nga fletë kthesat për dorëzim personal.

Të paditurit në afatin ligjor kanë ushtruar përgjigjeje në padi, me të cilën nuk e kanë kontestuar kërkesëpadinë e paditësit dhe kanë propozuar gjykatës njësit kadastrale si në padi të kalohen në pronësi të paditësit pasi që të njëjtat i takojnë paditësit.

Të paditurit po ashtu i kanë propozuar gjykatës që të veprojnë konform nenit 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe të marr aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore dhe e ka njoftuar gjykatën se heqin dorë nga e drejta e ankesës.

Shpenzimet nuk i ka kërkuar.

Gjykata për ta vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe gjykuar drejtë këtë çështje kontestimore juridiko-civile, bëri administrimin e provave të shkruara duke e bërë leximin e këtyre provave: u lexuan certifikata e pronës me numër ..., certifikata e vdekjes me numër V ... dhe V ..., Ekstraktet nga regjistri qendror i gjendjes civile E ..., ..., dhe përgjigjet, pa vërejtje.

Pas vlerësimit me kujdes dhe ndërgjegje të provave në tërësi dhe të secilës një nga një, e në pajtim me dispozitat e nenit 8 të LPK-së dhe bindjes së lirë të gjykatës, gjykata lidhur me këtë çështje kontestimore konstatoi këtë gjendje faktike:

Pasuria kontestuese evidentohet në emër të ndjerit I. T., baba i të paditurve. Të paditurit janë fëmijët e të ndjerit I. T.. Këto njësi paditësi i ka blerë, i ka paguar dhe i ka në posedim, në të njëjtat e ka fituar të drejtën e pronësisë edhe mbi bazën e parashkrimit fitues.

Se pasuria kontestuese, evidentohet në emër të I. T., baba i të paditurve, këtë fakt gjykata e ka vërtetuar nga thëniet në padi, certifikatat e pronës, e cila gjenden në shkresat e lëndës dhe se ky fakt nuk ishte kontestues në mes të palëve ndërgjyqjese.

Se të paditurit Sh.(I.) T., nga ... dhe Xh.(I.) T., nga fshati ..., janë pasardhësit e të ndjerit, këtë fakt gjykata e konstatoi nga thëniet në padi, certifikatat e vdekjes për paraardhësit e të paditurve dhe ekstraktet e lindjes për të paditurit si dhe përgjigjja në padi.

Se paditësi e ka blerë pasurin kontestuese, këtë fakt gjykata e vërtetoi, nga thëniet në padi, ku është shënuar se këto njësi kadastrale, janë blerë në muajin mars të viti 1973, në shumë prej 20,000 DM. Po ashtu nga thëniet në padi, është vërtetuar se paditësi e ka paguar shumën e kontraktuar.

Se paditësi është në posedim të pasurisë kontestuese, këtë fakt gjykata e vërtetoi nga thëniet në padi, e ky fakt është pohuar edhe nga pala e paditur me përgjigje në padi, ku kanë theksuar se pronat kontestuese të cekura si në padi janë në posedim të paditësit dhe të njëjtat i shfrytëzon paditësi pa u penguar nga askush.

Paditësi e ka fituar të drejtën e pronësisë me posedim, sepse i ka në shfrytëzim- posedim të papenguar nga askush përfshirë edhe të paditurit dhe në të njëjtat e ka fituar të drejtën e pronësisë me parashkrim fitues, sepse me dispozitën e nenit 40 par. 1 të Ligjit për Pronësi dhe të Drejta tjera Sendore, me nr. 03/L-154, është përcaktuar se: “personi i cili me mirëbesim e ka 20 vjet në posedim të pandërprerë një paluajtshmëri ose një pjesë të sa e fiton të drejtën e pronësisë në të”.

Meqenëse të paditurit nuk e kontestojnë kërkesëpadinë e paditësve dhe i kanë propozuar gjykatës që të nxjerr aktgjykim në bazë të pohimit, dhe kërkesat janë të disponueshme për palët, gjykata konform nenit 148 par. 1 të LPK-së, me të cilin përcaktohet se: “në qoftë se të paditurit deri në përfundimin e shqyrtimi kryesor të çështjes e pohon kërkesëpadinë e paditësit pjesërisht apo tërësisht, gjykata e jep pa shqyrtim të mëtejshëm aktgjykimin me të cilin e pranon pjesën apo të gjithë kërkesëpadinë (aktgjykim në bazë të pohimit)”, vendosi pa shqyrtim të mëtejshëm si në dispozitiv të këtij aktgjykimi

Po ashtu konform nenit 198 par 1 me të cilin përcaktohet se: “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritore, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”, ka nxjerrë aktgjykim pa caktuar seancë gjyqësore sepse nga përgjigja në padi është konstatuar se në mes palëve nuk është kontestuese gjendja faktike dhe nuk ekzistojnë pengesa të tjera.

Palët ndërgjyqësore mund të paraqesin ankesë në kuptim të nenit 181.2 të LPK-së, me të cilën dispozitë është paraparë se shkaqet nga të cilat mund të goditet aktgjykimin në bazë të pohimit janë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore apo nga shkak se deklarata e pohimit është dhënë në lajthitje apo ndikim të dhunës apo mashtrimeve, nga kjo del se aktgjykimin në bazë të pohimit nuk mund të goditet për shkak të konstatimit të gabuar të gjendjes faktike dhe as për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale.

Gjykata i detyroi paditësit që ta paguajnë taksën shtesë për padi në shumë prej 40.00€ këtë shumë e ka caktuar duke u bazuar në vlerën e kontestit. Ndërsa sa i përket shpenzimeve të procedurës gjykata vendosi që secila palë ti përballoj shpenzimet e krijuara, pasi me përgjigje në padi nuk i kanë kërkuar shpenzimet e procedurës, konform nenit 452.2 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA NË KAÇANIK
2023:251963 i datës 01.10.2024

Gjyqtari:
Riza LIVOREKA

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi, pala e pa kënaqur, ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, ankesa i paraqitet Gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate (neni 181.2 të LPK-së).

Dërguar me datën 01.10.2024

Paditësit 1x1

Të paditurve 2x1

Numri i lëndës: 2023:251962
Datë: 01.10.2024
Numri i dokumentit: 06234002